



**Dr. Genti Pano. Lektor, Zv. Dekan**

Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane  
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit  
Universiteti i Sporteve të Tiranës

*gpano@ust.edu.al*  
*+355 69 22 07 245*

### ***Bio e shkurtër***

**Dr. Genti Pano**, ka lindur në 16 Qershor 1983 në qytetin e Pogradecit. Në vitet 2001-2005 kryen studimet Universitare në, Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, sot “Universiteti i Sporteve të Tiranës”, ku Diplomohet dhe merr titullin: “Mësues i Edukimit Fizik” në Specialitetin, “Volejbolli”. Në vitin 2001 aktivizohet si Gjyqtar Volejbollit pranë “Federatës Shqiptare të Volejbollit dhe në vitin 2009 merr titullin “Gjyqtar Kategorisë së I-rë”. Në vitin 2010 merr titullin “Gjyqtar i Kategorisë Ndërkombëtare” në Volejbollin e Plazhit (*Beachvolleyball*). Në vitet 2007-2009 kryen studimet dhe Diplomohet në, “Master European” në “Shëndet dhe Aktivitet Fizik” në Universitetin Italian të Sportit dhe Lëvizjes “Foro Italico” Romë. Në vitin 2008 merr Diplomë nga Universiteti i Danimarkës së Jugut. Programi: Popullsi specifike: Të rinjtë dhe Aktiviteti Fizik ku merr certifikatë nga Universiteti i Danimarkës së Jugut. Programi Intensiv “ERASMUS” për: Aktivitetin Fizik dhe Fëmijët në Raport me Obezitetin dhe Shëndetin (*Internshipi i Masterit European*). Në vitin 2008 merr certifikatë nga Universiteti Gjerman i Sportit në Këln, “Programi i Masterit European në Shëndet dhe Aktivitet Fizik (*Internshipi i Masterit European*). Që prej Marsit 2010 deri Shtator 2020 punon si punonjës kërkimor shkencor/lektor në “Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit”, “Departamenti i Veprimtarisë Fizike Shëndetit dhe Rekreacionit” pjesë e UST. Në tetor të vitit 2018, mbron dhe fiton titullin “Doktor” në Shkenca Sportive. Në shtator të vitit 2020 kalon si lektor pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, Departamenti i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane. Aktualisht mban postin e Zv. Dekanit të këtij Fakulteti.